

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurit A. M. nga fsh. D. Komuna e Gjakoves, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH ne Prizren PP/II.129/17 te dt 20.04.2017 për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2/1 te KP-së, në prezencën e të akuzuarit dhe mbrojtësit me autorizim av. V. O., prokurorit te shtetit Fatos Ajvazi, më dt.25.10.2017, mur dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri :

A. M., i lindur *data e lindjes...* ne N. S. tani me banim ne fsh. D. KK Gjakove nga i ati I. dhe e ema R., ka te kryer shkollën fillore, i martuar babe i 5 femive, hotelier, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. te Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt.15.01.2017 rreth orës 16,10 min, ne fsh. D., komuna e Prizrenit, e perdore dokumentin publik te falsifikuar apo te ndryshuar si origjinal ne atë mënyrë qe derisa patrulla e policisë kufitare po bënte kontrollin ne po ate vend dhe ne momentin kur patrulla policore kishte ndaluar automjetin e markës “Citroen Berlingo” me targa regj. *Numri i targës...*, ngjyre e zeze te cilën e voziste A. M., gjate verifikimit te targave është konstatuar se te njëjtat targa ishin te falsifikuara te punuara me material tjetër, dhe se te njëjtat i përkisnin automjetit tjetër te markës se njëjtë, ashtu qe i pandehuri kishte keqpërdore duke e përdorur si origjinal ne qarkullim publik.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2/1 te KP-s.

Pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur ne mes te prokurorit te shtetit pranë Prokurorisë Themelore ne Prizren – Departamenti i përgjithshëm dhe te akuzuarit A. M. me mbrojtësin av.V. O., PP/II.129/17 te dt 21.04.2017

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3,4,41,43, 46 të KP-se, te pandehurit i shqipton :

DENIM ME GJOBË

Ne shume prej 300 (treqind) euro i cili dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nese dënimi ne te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin ligjorë I njejtj do te zëvendësohet ne dënim me burg duke llogaritur 20 euro 1 dite burg gjegjësisht 15 dite burg.

Obligohet I pandehuri qe te i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, ne emër te paushallit gjyqësor te paguan shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzën , PP/II.129/17 te dt 20.04.2017, ndaj te akuzuarit A. M. nga fsh. D. Komuna e Gjakoves, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2/1 te KP-

Përkitazi lidhur me aktakuzën , PP/II.129/17 te dt 21.04.2017,prokuroria themelore kane lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë me te akuzuarin A. M. me mbrojtësin av. V. O..

Në shqyrtimin e dt.25.10.2017 i mbajtur ne këtë çështje penale përkitazi për marrëveshjen e cekur me lartë gjykata bazuar ne nenin 233 te KPP-së, ka vlerësuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka dëgjuar te akuzuarin ne prezencën e mbrojtësit te tij, dhe ka konstatuar se pranimi është bere vullnetarisht nga ana e te akuzuarit pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Gjyqtari gjykues konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore konform nenit 233 paragrafi 18 i KPP-së, andaj ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në seancë ka shqiptuar edhe dënimin në suazat e marrëveshjes në mes të palëve.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPPK-se.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.808/17 të dt.25.10.2017

Procesmbajtësja:
Halime Nixha

Gjyqtari:
Refki Piraj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit ne Prishtine , e nëpërmjet të kësaj gjykate.